

AKT THEMELIMI I SHOQERISE

“Just travel” Sh.p.k.

Sot, më datë 10/09/2021, personat e mëposhtëm:

1. Znj. Rudina Xhunga, shtetase shqiptare, e bija e Engjellit, lindur më 22/06/1972 në Vlore, banuese në Tirane në adresën Sheshi Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 18, Ap.22, Trane mbajtës i letërnjoftimit (karte identiteti) me nr. 035632278 dhe nr. Personal H25622118R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe

2. Znj. Irma Dudushi, shtetase shqiptare, e bija e Panajotit, lindur më 18/04/1980 në Korce, banuese në Tirane në adresën: Rruga Brigada VIII, hyrja 2, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit (karte identiteti) me nr. 035234433, dhe nr. Personal I05418172M madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, në perputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, vendosi të themelojë Shoqërine tregtare të emërtuar “**Just travel**” Sh.p.k.

Neni 1

Themelimi, Emri dhe Forma

- 1.1 Themelohet një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e emërtuar (në vijim e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria është themeluar sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërite tregtare”, (i ndryshuar) si dhe fiton personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).
- 1.3 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në perputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me Aktin e Themelimit dhe me Statutin.
- 1.4 Emri dhe emërtimi tregtar i Shoqërisë është “**Just travel**” Sh.p.k.
Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit (me pas referuar si “QKB”).
Shoqëria do të organizohet si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K.).



Neni 2

Selia

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet me seli në adresën:

Rruga Tish Daija, Kompleksi "Kika 2", Shkalla nr.8, Njesia Administrative nr.5, Zona kadastrale 8260, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësie dhe të krijojë filiale në qytete të ndryshme të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj me vendim të Asamblese së Ortakëve.

Neni 3

Objekti

Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në baze të legjislacionit shqiptar.

Me konkretisht por pa u kufizuar në to, shoqëria ka për objekt:

Agjenci turistike, tour operator, prerje biletash për avion, për transport detar dhe rrugor, organizimi i tureve turistike brenda dhe jashtë vendit, veprimtaria financiare e këmbimeve valutore exchange, shërbime transporti, kurse trainimi për agjent udhëtimi, sigurancione, agjent imobiliar, ushtrim i veprimtarisë të ndërmjetësimit në sigurinë si agjent, pjesëmarrje në projekte të ndryshme.

Shoqëria mundet gjithashtu të ushtrojë çdo lloj tjetër biznesi apo aktiviteti të ligjshëm dhe/ose mund të angazhohet në çdo veprimtari të ligjshme ose aktivitet të lejueshëm nga legjislacioni shqiptar në fuqi për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i cili here pas here mund të ndryshohet në përputhje me dispozitat ligjore të këtij Statuti si dhe të ligjit të zbatueshëm.

Të gjitha këto veprimtari të lartpërmendura duhet të kryhen brenda kufijve dhe sipas dispozitave ligjore që rregullojnë ushtrimin e tyre.

Ortakët e Shoqërisë, deklarojnë dhe garantojnë se gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit tregtar të Shoqërisë, ata nuk do të ndërmarrin, themelojnë, kryejnë apo ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër private të njëjtë apo të ngjashme me objektin e aktivitetit të Shoqërisë e cila mund t'i shkaktojë konkurrencë Shoqërisë apo mund të dëmtojë interesat e kësaj të fundit.

Neni 4



Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 5

Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 10.000 leke (Dhjete mije leke). Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota me vlere 5100 Leke (pese mije e njeqind) dhe 4900 Leke (kater mije e nenteqind), dhe eshte paguar e zoterohet teresisht nga ortakët e shoqerise, perkatesisht 51% te kuotave, **Znj. Rudina Xhunga** dhe 49% te kuotave **Znj. Irma Dudushi**.

-Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve shtrihet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

-I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar dhe zotërohet tërësisht nga Ortakët e Shoqërisë.

Neni 6

Organet e Shoqerise

Drejtimi i Shoqerise kryhet nepermjet organeve te shoqerise, te cilat jane:

- a. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- b. Administratori.

Organizimi dhe funksionimi i Shoqerise rregullohet nga Statuti.

Neni 7


Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte vendimmarres i Shoqerise.

Neni 8

Administratori

Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.



Znj. Irma Dudushi, shtetase shqiptare, e bija e Panajotit, lindur më 18/04/1980 në Korce, banuese në Tirane në adresën: Rruga Brigada VIII, hyrja 2, mbajtës i letërnjoftimit (karte identiteti) me nr. 035234433, dhe nr. Personal I05418172M madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, caktohet Administratore e pare e shoqerise me mandat 5 vjecar.

Neni 9

Dispozita Perfundimtare


Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Akt Themelimi, do te zbatohet parashikimet e Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar.

Ky Akt Themelimi nenshkruhet rregullisht ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe.

Per regjistrimin e Aktit te Themelemit dhe Statutit te Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit autorozohet Z.Arnold Domi, i cili mund te kryeje cdo veprim ne lidhje me regjistrimin e Shoqerise

ORTAKET THEMELUES

Znj. Rudina Xhunga



Znj. Irma Dudushi

